



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 19  
Prishtinë, 16 shtator 2008, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Syla, Mimoza Ahmetaj, Bujar Bukoshi, Qamile Morina, Armend Zemaj dhe Teuta Hadri.

Munguan: Flora Brovina dhe Sllobodan Petroviq.

Nga Ministria e Shëndetësisë: ministri Alush Gashi dhe zëvendësministrja Mybera Mustafa

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Drita Morina – zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta- nëpunëse administrative.

Nga NDI: Shefki Kastrati

Nga KDI: Fitore Zeneli

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Takimi me ministrin e Shëndetësisë Alush Gashi  
- *Tema: Gjendja në shëndetësi dhe procedimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore*
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Mimoza Ahmetaj** - Propozoi që diskutimi në takim të mos përqëndrohet vetëm në Ligjin për sigurimet shëndetësore, por edhe në gjendjen e shëndetësisë.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Kryesuesi - Konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.*

## **3. Takimi me ministrin e Shëndetësisë Alush Gashi - Tema: Gjendja në shëndetësi dhe procedimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore**

**Sadik Idriz** - Tha se të ftuar e kemi ministrin e Shëndetësisë Alush Gashin. Do të diskutojmë për gjendjen në shëndetësi, cilat janë problemet me të cilat ballafaqohet Ministria dhe çka mendohet të bëhet për ta tejkaluar këtë gjendje. Na intereson Ligji për sigurimet shëndetësore, ku ka arritur Ministria me procedurë lidhur me këtë ligj, si dhe gjendja me barna në shëndetësi etj. Ky komision dëshiron të jetë partner i mirë për këtë qëllim. Pa Ligjin për sigurimet shëndetësore, shëndetësia nuk mund të qëndrojë në këmbë të veta. Fjalën ia dha ministrit të Shëndetësisë, z. Alush Gashi.

**Alush Gashi - ministër i Shëndetësisë** - Pasi falënderoi për ftesën për takim tha se i ka informuar anëtarët e Komisionit në mënyrë elektronike lidhur me raportin e Bankës Botërore për Ligjin për sigurimet shëndetësore. Më 10 janar 2008 e kam marrë ta udhëheq Ministrinë e Shëndetësisë në një gjendje shumë të rëndë, që më së miri e përshkruan raporti i Auditorit të Përgjithshëm që e tregon gjendjen e vitit 2007. Rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm të vitit 2006 gjatë vitit 2007 nuk kanë arritur të zbatohen. Gjendja në shëndetësi, me tenderë të parealizuar të vitit 2006 dhe të pjesës më të madhe të vitit 2007, në të cilën niveli i shpërdorimeve në sistem, siç jeni të informuar edhe gjatë përgjigjeve për pyetjet parlamentare, është e papranueshme. Një prej veprimeve të para ka qenë bashkëpunimi shumë konstruktiv me kryetarin e Komisionit që gjendjen në këtë ministri e njeh shumë mirë. Kam gjetur konflikte institucionale interesi, si bie fjala Inspektorati i Farmacisë në mënyrë të kundërligjshme ka qenë në AKPM. Këtë çështje e kemi ndryshuar. Kanë qenë të palicencuara një numër i madh i farmacive, një numër i madh i praktikave private, si dhe mungonin inspektimet në institucione etj. Në këtë lëmi kemi të arritura që në baza ditore ua ofrojmë të gjithë qytetarëve nëpërmjet faqes së internetit të Ministrisë së Shëndetësisë. Kam gjetur një buxhet që është miratuar nga ish-qeveria, ku për tërë listën esenciale kanë qenë të parapara 8.8 milionë euro për një popullatë më se 2 milionë. Një prej veprimeve të para ka qenë të shikohet mundësia se ku mund të hiqet nga ndonjë investim kapital që të shtohet buxheti për farmaci dhe kemi arritur ta shtojmë atë buxhet, në ditë e para prej 2 deri në 2.5 milionë e gjysmë. Gjatë vitit me rishikim kemi arritur që ky buxhet të shtohet edhe për 4 milionë. Këto 16 milionë arritën ta përmirësonin gjendjen, por jo për tërë listën e barnave esenciale. Për vendin tonë nevojiten sigurisht më se 30 milionë për listën esenciale të barnave. Kërkoj mbështetjen e Komisionit që për buxhetin e vitit 2009 për farmaci - për listën esenciale - të na ndihmojë të kemi më se 30 milionë euro. Qeveria është dashur t'i vazhdojë licencat në mënyrë administrative, sepse një numër i mjekëve nuk ka pasur mjaft kredi për ta vazhduar profesionin e vet. Më nevojitet mbështetja e Komisionit që të ketë buxhet për edukimin permanent. Nevojitet mbështetja juaj për pajisje mjekësore, për integrimin e profesionistëve tanë në radhët e asociacioneve. Vetëm kërkesa e Qendrës Klinike Universitare të Prishtinës është më se 15

milionë. Nëse e shikoni me kujdes këtë kërkesë do të shihni se ajo është mjaft modeste. Keqpërdoruesit janë të shumtë. Kemi një numër të madh të zyrtarëve të lartë për të cilët ka kallëzime penale që ende nuk po ekzekutohen. Sa u përket rasteve të trajtimit jashtë vendit, të grumbulluara që nga viti 2003, me rritjen e buxhetit për atë sektor, besojmë se deri në fund të vitit nuk do të kemi raste nga vitet e kaluara. Qëllimi është që këto raste të trajtohen në Kosovë. Këtu ka probleme, sepse ka shumë presione nga zyrtarë të ndryshëm që udhëzimi administrativ për trajtim jashtë vendit të mos zbatohet. Sipas udhëzimit, për trajtim jashtë vendit, nuk mund të lejojmë të shkohet për raste estetike. Çështje tjetër e rëndësishme është ajo e angiografisë. Aparati i angiografisë është lëshuar në punë pa bërë porosi për material shpenzues. Nga raportet e auditivit, si të jashtëm ashtu edhe të brendshëm, shihet se është investuar në projekte që nuk ekzistojnë. Nuk mund të ketë shërbime shëndetësore të mira nëse nuk ka sundim të ligjit. Këto ditë përmendet edhe gjendja e sindikatave. Jemi marrë vesh me kryesinë e sindikatave që të kemi takime të rregullta. Këto takime i mbajmë. Kërkesat e Sindikatës janë legjitime. Unë nuk e di sa duhet të rriten të ardhurat, por e di që këto të ardhura janë shumë të ulëta, sepse që nga viti 2001 këto nuk janë rritur fare dhe nga ajo kohë ka pasur një inflacion që besoj nuk është nën 20%. Nuk është kërkesë e madhe kjo për kushte optimale të punës dhe këto kushte nuk mund të krijohen pa ndërrim të kësaj strukture buxhetore. Kërkesë legjitime është Ligji për shëndetësinë. PSSP-ja nuk e ka nënshkruar këtë ligj për dy arsye: a) nuk ekziston kostoja buxhetore, b) nuk është argumentuar se ku do t'i marrë Qeveria të hollat për vitin 2007. Ne tani e kemi analizuar këtë kosto në mënyrë që Ligji të nënshkruhet nga kryetari Sejdiu dhe kjo kosto është 154 milionë. Për buxhetin e shëndetësisë për të tri nivelet, vështirë se i arrijmë 80 milionë. Pra problem do të jetë zbatimi i këtij ligji. Andaj gjatë këtij viti në Ministrinë e Shëndetësisë kemi punuar në vazhdimësi për Ligjin për shëndetësi. Më 11 prill e kemi pasur konferencën e Bankës Botërore që e vazhduam më 13 maj. Sipas studimit të Bankës Botërore ligji i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk është i zbatueshëm për shkak të numrit të vogël të të punësuarve dhe rekomandohet të orientohemi në Ligjin e sigurimeve shëndetësore të Estonisë, të Sllovenisë dhe të Kirgistanit. Pasi Estonia ishte rekomandimi i parë i Bankës Botërore dhe pasi kjo bankë e ka mbështetur shumë Estoninë në zbatimin e ligjit, Organizata Botërore e Shëndetësisë na ka mbështetur, që një grup nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Kuvendi të shkojë për vizitë studimore në Estoni. Zëvendësministria do ta shpjegojë këtë sistem që Banka Botërore ia rekomandon Kosovës. Por për atë sistem na nevojitet një reformë e thellë në sistemin juridik. Kam vendosur ta formoj grupin për rihartim të ligjit nga Ministria e Shëndetësisë, Kuvendi, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Sindikata e Shëndetësisë, shoqëria civile dhe mbi të gjitha Ministria për Ekonomi dhe Financa si dhe Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

**Mybera Mustafa – zëvendësministre** - Tha se ka qenë kryesuese e grupit në vizitën studimore në Estoni. Raportin, të detajuar, tha se ua kanë përcjellë me e-mail kryetarit të Komisionit dhe dy nënkryetarëve. Në takim ajo e bëri një elaborim të shkurtër të atij raporti. Pjesëmarrës në këtë vizitë ishin Mybera Mustafa - zëvendësministre e Shëndetësisë, z. Armend Zemaj - deputet i Kuvendit të Kosovës, anëtar i Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z. Flakron Sylejmani - këshilltar në Kabinetin e ministrit të Shëndetësisë, dr. Fatime Arenliu-Qosaj, këshilltare në Kabinetin e ministrit të Shëndetësisë, dr. Afrim Sylejmani - këshilltar në Kabinetin e ministrit të Shëndetësisë, dr. Arsim Qavdarbasha - drejtor i Agjencisë për Komisionimin e Përkujdesjes Shëndetësore, z. Nexhip Sheholli - shef i Divizionit të Buxhetit dhe Financave në AKPSH dhe dr. Skender Dreshaj - drejtor i Spitalit Rajonal të Pejës. Objektiva të vizitës kanë qenë të themelohet bashkëpunimi në nivel homologësh me Estoninë në fushën e shëndetësisë, njohja me sistemin e reformave në Estoni me fokus reformat në sistemin financiar që nga viti 1990 dhe të merren informata nga dora e parë. Kemi bërë vizita në institucione shëndetësore për t'u njoftuar më për së afërmi për menaxhimin në nivel institucional, takime me ministrin e Shëndetësisë, ligjërata interaktive të niveleve më të larta sociale të Estonisë dhe të fondit për sigurime shëndetësore. Vizita studimore është përkrahur nga Banka Botërore.

Estonia kishte një popullatë prej 1.4 milion banorë dhe sipërfaqe 40 mijë kilometër katrorë. Në Estoni para reformave kanë funksionuar 22 fonde rajonale jokompetitive. Që nga viti 1994 janë të koordinuara nga Fondi Qendror i Sigurimeve. Në vitin 2001 u themelua Fondi i Sigurimeve Shëndetësore me katër departamente rajonale. Sigurimet shëndetësore në Estoni e mundësuan sigurimin e qëndrueshëm të të ardhurave financiare, rritjen e transparencës, forcuan parimin e solidaritetit, i ndanë ofruesit nga blerësi i shërbimeve shëndetësore, e ngritën nivelin e të drejtave të pacientëve. Në anën tjetër këto sigurime e rritën koston administrative, i ngritën sfidat e ballafaqimit me kontrollin e shpenzimeve dhe me definimin e shpenzimeve të pakos bazike. Fondi i Sigurimeve Shëndetësore në Estoni ishte strukturë legale e pavarur publike me organizim të trefishtë të bordit mbikëqyrës. Fondi i Sigurimeve Shëndetësore është pronar i asetëve dhe është përgjegjës për obligimet brenda asetëve. Bordi menaxherial ishte udhëheqës i strukturave të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore që plotësisht u përgjigjeshin funksioneve të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Puna e këtij fondi kontrollohej nga këshilli i auditit të brendshëm. Procesimi i të dhënave ishte tërësisht elektronik. Fondi i Sigurimeve siguronte më se 1000 shërbime shëndetësore, përveç shërbimeve dentare për të rritur. Planifikimi i buxhetit bëhej çdo 4 vjet dhe nëpërmjet bordit për mbikëqyrje i propozohej qeverisë që e miratonte atë. Lista e shërbimeve aprovohej nga Kabineti i Ministrisë së Shëndetësisë. Çmimet nuk ndryshonin sipas ofruesve dhe Fondi i Sigurimeve aplikonte ABC (activity bazik cosing) për ta përcaktuar çmimin e shërbimeve. Kualiteti i shërbimeve shëndetësore sigurohej me anë të kontrollit, përkrahjeve, auditeve, ankesave të pacientëve dhe nga indikatorët e performancave të ofruesve të shërbimeve.

**Sadik Idriz** – Tha se Komisioni ka formuar një grup që po merret me monitorimin e Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi. Do të dalim me raport për seancë në Kuvend. Raporti i auditimit për vitin 2006/2007 është ashtu si është. Për atë vit bordi i QKUK-së ka qenë shumë autonom me buxhet dhe Ministria nuk ka pasur kurrfarë ndikimi në buxhetin e QKUK-së. Në vitin 2006 buxheti i Ministrisë për të gjitha nivelet ka qenë 8 milionë - asnjëherë më shumë. Për shërim jashtë vendit kemi pasur 200 mijë euro. Tani ka shumë më shumë mjete.

**Teuta Hadri** – Tha se edhe pse në mandatet e kaluara janë ftuar ministrat e Shëndetësisë, ata nuk iu kanë përgjigjur ftesës, por zakonisht e kanë dërguar dikë për përfaqësim dhe asnjëherë nuk kanë ardhur vetë. Në këtë mënyrë gjithmonë është anashkaluar çështja e gjendjes në shëndetësi për shkak të mospranisë së ministrit. Ju, z. ministër, i jeni përgjigjur ftesës së këtij komisioni dhe tani kërkon mbështetjen e Komisionit. Kjo tregon interesimin tuaj për ta tejkaluar këtë gjendje në shëndetësi. Komisioni për Shëndetësi në të gjitha mandatet ka punuar mjaft, duke i shqyrtuar ligjet dhe miratuar ato, por ka punuar edhe jashtë kësaj, duke dalë për të bërë kontrole të gjendjes së shëndetësisë. Shëndetësia në Kosovë është në gjendje të një shoqate humanitare. Gjendja në gjinekologji është bërë alarmante për shkak të mungesës së shtretërve me rastin e renovimit të repartit të lehonave. Tenderi që është dashur të përfundonte për gjashtë muaj nuk ka përfunduar ende, por ka zgjatur një vit. Kështu nga 82 shtretër, tani ai repart është me 30 shtretër që i janë marrë repartit të shtatzënave për shërbim për 6 muaj, pra dy paciente ndajnë një shtrat. Ju si ministër në aktivitetin tuaj, a keni paraparë sa do të zgjatë investimi jokapital, por shumë i vogël, investimi i atyre shtretërve? Ndoshta gjenden edhe donatorë që pacientet tona të mos ballafaqohen më rrezikun e sëmundjeve ngjitëse. Ju jeni personi me kualifikimin më të lartë të profesionalizmit në Kosovë dhe konsideroj se do të ndërmerri hapa konkretë për rritjen e pagave të punëtorëve shëndetësorë. Nuk jam kundër ngritjes së pagave për punëtorët e arsimit, por duhet të llogariten orët e punës dhe profesionalizmi. Ne po ballafaqohemi me një buxhet të vogël, por me përgjegjësi të mëdha.

**Gjynaze Syla** – Tha se ka një shqetësim të thellë për gjendjen në sistemin shëndetësor. Mendoj se duhet një intervenim shumë më i shpejtë dhe një mobilizim i të gjithëve. Ajo çka dëgjova këtu, më shumë ishte një konstatim i gjendjes së sistemit shëndetësor. Dua të dëgjoj nga Ministria se çka do të bëhet për secilën nga këto, dua ta shoh një vizion të qartë. Sipas agjendës legislative të këtij viti Ministria e Shëndetësisë nuk ka paraparë asnjë ligj për këtë vit. Çështje urgjente është hartimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore dhe format se si do të krijohet fondi. Të gjithë duhet të mendojmë për një sistem të qëndrueshëm, duke e përfshirë qëndrueshmërinë financiare. Kjo kërkon jo vetëm angazhimin e Ministrisë, sidomos të Ministrisë në nivelin e Qeverisë dhe duhet kërkuar që shëndetësia të jetë prioritet për Qeverinë. Besoj se duhet të jetë prioritet edhe për Kuvendin. Zgjidhjet duhet filluar nga Ministria e Shëndetësisë me një riorganizim të fuqishëm në Ministri dhe në QKUK. Unë, si anëtare e Komisionit, jam e gatshme të ndihmoj, por kërkoj nga Ministria ta ketë

një vizion të qartë për objektivat, si do të realizohen ato dhe për caktimin e afateve? Cila është zgjidhja, nga do të shkoni dhe si do t'i zgjidhni këto probleme? Sa u përket pagave, këto janë kërkesa legjitime të punëtorëve shëndetësorë nëpërmjet Sindikatës së Punëtorëve. Angazhimi i Ministrisë dhe i të gjithë neve është përmbushja e këtyre kërkesave. Ajo tha se personalisht i mbështet kërkesat e punëtorëve që i konsideron legjitime.

**Mimoza Ahmetaj** – Parashtrori pyetje për ministrin: Z. ministër, kur e keni marrë këtë detyrë, a keni pasur një plan të punës? Janë investuar 9 milionë euro për sistemin informativ në shëndetësi nga Banka Botërore, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe nga Agjencia Evropiane për krijimin e këtij sistemi që është po aq i rëndësishëm sa edhe çmimorja e shërbimeve shëndetësore. Asnjë rezultat nuk shihet nga këto investime dhe kjo le mundësinë të dyshohet se janë manipuluar këto fonde. A mund të na tregoni se kush është përgjegjës për këtë sistem informativ brenda Ministrisë? Pse ai person nuk ju ka shoqëruar sot që të kemi mundësi të marrim informata? Kohë më parë i janë alokuar edhe 2 milionë euro Ministrisë së Shëndetësisë për trajtimin e pacientëve jashtë vendit, sidomos për kardiokirurgji. Mos nuk do të ishte më mirë sikur këta 2 milionë të investoheshin në Kosovë dhe trajtimi i pacientëve të bëhej brenda vendit?

**Qamile Morina** - Tha se gjendja në shëndetësi është tejet e rëndë. Konsideroj se sistemi shëndetësor në Kosovë duhet të fillojë nga e para, duhet të ndryshohet organogrami i Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe duhet të bëhen ndryshime të mëdha të organizimit. Në shëndetësinë primare dhe sekondare gjendja është shumë e rëndë, por ajo që është në gjendje shumë më të rëndë është terciarja. Ju në programin tuaj, z. ministër i keni pasur pikat që kanë ekzistuar edhe në programet e kaluara. I pari ishte financimi i qëndrueshëm, domethënë është bazuar në fondet e sigurimit shëndetësor. Nëse ju kujtohet, unë edhe në seancë plenare jua kam parashtruar pyetjen për fondin e sigurimeve shëndetësore. Në momentin kur është marrë ky mandat e kanë pasur të qartë se ekziston ky problem. Është dashur të planifikohet dhe menjëherë t'i hyhet rregullimit të financimit të qëndrueshëm. Ajo që ka qenë dekurajuese ka qenë se në strategjinë legjislative asnjë ligj nuk figuron nga shëndetësia. Ju e keni përmendur decentralizimin, ju thoni se është decentralizimi, por nuk e di sa e keni mbikëqyrjen në qendrën terciare (tretësore). Prapë keni pasur pyetje nga unë për keqpërdorimet e mëdha dhe ndonjëherë kam marrë përgjigje se auditimi është duke e vlerësuar gjendjen. Buxheti që ishte 5 milionë euro për vitin e kaluar fare nuk është përdorur ashtu siç parashihej me rregullat. E njëjta gjë po vazhdon edhe këtë vit. Jam duke folur në radhë të parë për mjekimin intensiv të interesit nacional. Mjekimi intensiv qendror është vlerësuar se ka kapacitete shumë të vogla, është planifikuar dhe është bërë projekti për zgjerimin e mjekimit intensiv. Ai projekt është pranuar. Mjetet për atë projekt janë alokuar. Në ndërkohë gjithçka ka ndryshuar, që ishte në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Tani mjekimi intensiv po vazhdon të bëhet në formën kundërligjore. Ai mjekim intensiv është rinovuar dy deri tri herë deri tani. Pacientët kanë pësuar këtyre ditëve. Mendoj se në çdo shtet normal dikush ishte dashur të jepte dorëheqje. Kemi raste kur njerëzit nga Ministria janë angazhuar për transportin e të sëmurit, sepse nuk kishte vend dhe janë bërë marrëveshje për pagesën e transportit, domethënë në prani të punonjësve të Ministrisë. Ky është vetëm një nga projektet që nuk zhvillohet ashtu siç është projekti. Me Ligjin për shëndetësi ju z. ministër e keni mbikëqyrjen, ju e keni autoritetin që ta ndryshoni gjendjen. Thatë se i keni 16 milionë për barna. Këtu është lista e mungesës së barnave për mjekimin intensiv, ky është buxheti më i madh i mundshëm. Arsyet ju duhet t'i dini. Thoni se Qendra Klinike i kërkon 15 milionë. Problemi i vendeve në transicion përveç buxhetit është edhe mungesa e racionalizimit. Sistemi shëndetësor duhet të ndryshojë. Në QKUK statuti ekziston, por asnjë rregullore që obligon statuti nuk është nxjerrë.

**Rita Hajzeraj** – E pyeti ministrin se a ekziston një strategji konkrete për dalje nga ky kolaps në shëndetësi? Thatë se menaxherët në mandatin e kaluar kanë bërë keqmenaxhime. Çka është ndërmarrë ndaj këtyre personave dhe a keni strategji se çka do të ndërmerrni ndaj këtyre menaxherëve? E dimë tash se për barnat esenciale janë edhe 2.5 milionë, çka keni bërë ju për shtatë muaj që barnat esenciale të përmirësohen në krahasim me mandatin e kaluar? Bashkëpunimi ndërmjet drejtuesve të departamenteve ka probleme. Ku janë pengesat që Ministria nuk ka bashkëpunim me këta drejtues të departamenteve?

**Armend Zemaj** - Tha se kur dëgjojmë që sistemi i AKPM-së është menaxhuar nga jashtë institucioni dhe kur dëgjojmë nga një ministër se janë bërë 13 kallëzime penale dhe askush nuk

ndërmori asgjë, atëherë çka do të bëjmë ne si Komision Parlamentar për Shëndetësi, si do të mund ta ndihmojmë Ministrinë apo shëndetësinë në nivel të Kosovës? Çështje shumë të diskutueshme kanë qenë edhe raportet tuaja, z. ministër, me drejtorin e QKUK-së. Nga jashtë duket se këto raporte nuk janë të mira. Këtë pyetje ia kam bërë edhe drejtorit të QKUK-së dhe ai më është përgjigjur se këto raporte janë shumë të mira. Më intereson të di si qëndron gjendja në qendrat e tjera mjekësore, sepse ne jemi koncentruar vetëm në QKUK që është një qendër që ndërlidhet me krejt rajonin.

**Nurishahe Hulaj** – E përgëzoj ministrin që e ka dërguar delegacionin nga Kosova për vizitë studimore në Estoni me qëllim që ta inicojmë zgjidhjen e shumë problemeve në shëndetësi. Po më interesojnë kontraktimet e shërbimeve shëndetësore. Nga raporti shihet se organizatat shëndetësore janë shndërruar në shoqëri aksionare, do të thotë është bërë edhe ndërrimi i pronës. Sa kuptova edhe spitalet janë bërë pronë e komunës, është bërë kontraktimi ndërmjet Organizatës Shëndetësore dhe Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. I kuptova dy indikatorë të rëndësishëm që reformimi është bërë me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore që është shumë e rëndësishme dhe elementare. Konsideroj se edhe Ministria e ka bërë këtë aktivitet për ta përdorur si model edhe për Kosovën, por normalisht për të kërkohet punë. Domethënë të dihet pronari dhe me kë të bëhet kontraktimi, domethënë është shumë transparente. Më intereson, si është bërë kontraktimi i shërbimeve, sa ka realizuar spitali? Nga raporti po e shoh se në Estoni prioritet ka mjekësia familjare e ky prioritet është edhe në Kosovë. Dallimi ndërmjet numrit të banorëve dhe të spitaleve është shumë i madh. Konsideroj se duhet t'ia japim një shtytje Fondit të Sigurimeve që ta kemi edhe në Kosovë.

**Bujar Bukoshi** – Tha se ky vend e ka trashëguar një gjendje ekstreme të rëndë në shëndetësi, madje deprimuese dhe kriminale. Pyetja e tij ishte, a kemi të bëjmë me fenomenin e hapjes së shëndetësisë? Konsideroj se pamundësia juaj si ministër për të ndërhyrë është problem i mosfunksionimit të shtetit juridik – prokurorisë, gjykatës etj. Pa filluar të ndryshohet diçka në këtë drejtim nuk mund të bëhet diçka për shëndetësinë. Propozoj të jemi në kontakt të vazhdueshëm. E falënderoj ministrin për korrektësi.

**Sadik Idriz** - Dëgjuam mjaft pyetje. Disa prej pyetjeve janë të lidhura drejtpërdrejt me gjendjen të cilën e kemi. Dikush është fokusuar në dokumentin që është shpërndarë pas vizitës në Estoni e që sot nuk është esenciale. Problem është kthimi i ligjit dhe si do të procedohet ai. Sa u përket barnave esenciale mjetet janë ndarë, por nuk kemi informata se ku kanë shkuar. Lidhur me strategjinë legjislativë të Ministrisë së Shëndetësisë nuk është shumë me rëndësi sa ligje po miratohen, por çështja është sa po zbatohen. E kemi rastin e Ligjit për sigurimin social dhe të Ligji për shëndetësi, që nuk po zbatohen për shkak të implikimeve buxhetore. Komisioni i mbështet kërkesat e Sindikatës për paga të punëtorëve të shëndetësisë, por kërkesat duhet të jenë në harmoni me shërbyesit e tjerë.

**Alush Gashi - ministër i Shëndetësisë** - Tha se programin e paraqitur në fillim jemi duke e zbatuar në faza ditore. Shqetësimi im më i madh është në atë që deputeti Bukoshi e theksoi. Vendi ynë sipas analizave të institucioneve ndërkombëtare që merren me keqpërdorimin e pushtetit, në veçanti të shëndetësisë, fatkeqësisht për vitin 2006/07 është në vendin e katërt në botë për keqpërdorim. Nuk do të bëhem pjesë e atyre keqpërdorimeve. Kjo është çështje e organeve të drejtësisë. Sikur të kisha të drejtë si ministër për t'i shkarkuar drejtorët, do t'i evidencioja keqpërdoruesit. Pa u pastruar sistemi prej keqpërdoruesve vështirë se mund të ecim përpara. Me shumë të drejtë u përmend çështja e barnave. Më lejoni t'juja citoj raportin për shpenzime – mallra, shërbime dhe investime kapitale. Më 12 shtator 2008 - Ministria e Shëndetësisë ka arritur zotime dhe kontraktime deri më sot për 93% të buxhetit. Do të thotë në krahasim me vitin e shkuar 190.9 % më shumë. Kjo nuk mjafton pa u pastruar sistemi prej keqpërdoruesve. Sa u përket pagave, kryeministri, në takim me Sindikatën e Shëndetësisë ka premtuar angazhim të drejtpërdrejtë për ta parë mundësinë e ngritjes së pagave. Sa i përket ligjit, Ministria e Shëndetësisë ka qenë shumë e ndërgjegjshme edhe pse Ligji ka qenë i miratuar në Kuvendin e Kosovës, ne kemi qenë të bindur se ky ligj nuk mund të zbatohet, andaj i kemi ndërmarrë të gjitha këto aktivitete të planifikuara deri në ditën e sotme. Ligjin e ri do t'ua ofrojmë Qeverisë dhe Kuvendit. Ne kemi qenë të vetëdijshëm se problem është buxheti, andaj në muajin e katërt e kemi filluar shqyrtimin e mundësisë për buxhet shtesë dhe për një muaj kemi bërë analizë që ia kemi ofruar Qeverisë. Jemi të bindur se një taksë indirekte për derivate të naftës, për sigurime, për alkool do ta rriste buxhetin për 38 milionë. Sistemi ynë shëndetësor nuk është i njëjtë me sistemin shëndetësor të vendeve në transicion. Jam shumë i inkurajuar për prioritetin që Komisioni ia ka dhënë monitorimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi. Kemi filluar

licencimin e spitaleve. Ne kemi vizion të qartë. Jemi të bindur se punëtorët shëndetësorë, me ligj duhet të veçohen nga shërbyesit civilë dhe ata duhet të paguhen sipas punës. Sa i përket faktit që dy lehona e ndajnë një shtrat, jua kujtoj se në QKUK- në vitin e kaluar kanë lindur 12.000 fëmijë. Në analizën që e kemi bërë në Ministrinë e Shëndetësisë afër 5.000 lindje, janë lindje që nuk janë dashur të kryhen në Prishtinë. Duke e parë këtë si problem e kemi filluar licencimin e materniteteve nëpër qendra të tjera. Kemi raste në QKUK, që një mjek dërgon për CT pacientë edhe pa e plotësuar anamnezën. Kjo është e patolerueshme. Jam i bindur se do ta vëmë nën kontroll. Në vazhden e inspektimit dhe të monitorimit të shpërndarjes së barnave kemi konstatuar se kompjuteri qendror në depon e Mazgitit është menaxhuar nga njerëzit jashtë institucionit. Keqbërësit janë të organizuar dhe kjo shkon në dëm të shëndetësisë dhe të pacientëve. Në organizimet aktuale, nëse ministri nuk ka të drejtë për të intervenuar, ndërsa ka detyrim të përgjigjet, ky është një sistem i çuditshëm dhe këtë shpresoj ta ndryshojmë. Sa i përket sistemit të informimit shëndetësor kemi konstatuar se plani i menaxhimit të buxhetit në Ministrinë e Shëndetësisë në vitin 2003 nuk ka qenë në funksion, sepse dikujt nuk i ka konvnuar të jetë në sistem, por i kanë punuar tabelat në Excel, ku të dhënat mund të ndërrohen çdo ditë. Sa i përket zhvillimit të SISH-it, duke i ditur mundësitë financiare, ne në kabinet kemi vendosur që prioritet t'i japim menaxhimit të barnave. Për pacientët kjo ka filluar në Prizren. Sa i përket bashkëpunimit, e kemi organogramin, në të cilin sekretari permanent çdo të hënë në orën 14:00 ka takim me të gjithë drejtorët e spitaleve. Raporti im me drejtorin e QKUK-së është i mirë dhe ne bashkëpunojmë. Realiteti është që Auditori i Përgjithshëm në QKUK ka gjetur shkelje të pakapërcyeshme. Kjo gjendje në shëndetësi kërkon mbështetje. Nga viti 2003 presin pacientë për trajtim kardiokirurgjik. Ne kemi marrë vendim të veprojmë në dy drejtime. Me këto mjete që na janë ndarë, t'i realizojmë të gjitha kërkesat nga viti 2003 dhe në të njëjtën kohë të investojmë në projekt të kardiokirurgjisë në QKUK. Nuk do ta përkrahim sistemin publik shëndetësor nëse ai është në dëm të pacientëve. Jemi duke u përgatitur për ta shpallur tenderin për menaxhimin e QKUK-së. Jam i bindur se nuk ka nevojë të durohen keqbërësit dhe jam i inkurajuar për mbështetjen e Kuvendit dhe të Qeverisë, por drejtësia duhet të veprojë më shpejt.

**Qamile Morina** - Tha se me Ligjin për shëndetësinë, ministri e ka mbikëqyrjen. Ministri e ka atë autoritet, ndoshta jo drejtpërdrejt, por dikush nga kabineti i tij po. Projekti për mjekimin intensiv ekziston. Kush nuk e përfilli projektin dhe kush i keqpërdori mjetet?

**Alush Gashi - ministër i Shëndetësisë** - Përgjigjen e kësaj pyetjeje e ka dhënë auditori. Janë dhënë mjete për punën që nuk është bërë. Unë nuk jam i interesuar të hyj në projekte që nuk ekzistojnë.

**Sadik Idriz** - Tha se ishte ky një takim i suksesshëm. Nëse e konsideroni që duhet të ndryshohet Ligji për shëndetësi, propozoj ta ndërmerrni nismën dhe Komisioni do t'ju përkrahë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

*Sadik Idriz*